



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 05, datë 21.10.2021

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:

“RIKONSTRUKSION NË DRSHTRR DIBËR, RIKONCEPTIMI DHE UNIFIKIMI I VESHJEVE STRUKTUREORE, REHABILITIMI I SHESHIT FUNKSIONAL DHE GODINËS SË KONTROLLIT TEKNIK”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË DIBËR

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të zhvilluesit Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Rikonstrukcion në DRSHTRR Dibër, rikonceptimi dhe unifikimi i veshjeve strukturore, rehabilitimi i sheshit funksional dhe godinës së kontrollit teknik”, me vendndodhje në Bashkinë Dibër, me zhvillues Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) miratimit të vendimit të VNM-së (Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis) përkatëse;
 - b) miratimit të akteve përkatëse sipas legjislacionit të posaçëm për trashëgiminë kulturore;
 - c) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë së Dibër.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU




A circular official stamp in blue ink. The outer ring contains the text "MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË" at the top and "TIRANË" at the bottom. The center of the stamp features the coat of arms of Albania. The stamp is partially obscured by a large, stylized handwritten signature in blue ink.

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA



A circular official stamp in blue ink. The outer ring contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" at the top, "AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT" on the sides, and "MINISTRIA E" at the bottom. The center of the stamp features the coat of arms of Albania. The stamp is partially obscured by a large, stylized handwritten signature in blue ink.